



Déontologie, neutralité, secret professionnel

# Masat e 8 qershorit

## Prezantimi

---

Qeveria ka ndërmarrë masa për të frenuar përhapjen e koronavirusit.

Ju lutemi t'i respektoni këto masa.

Në këtë mënyrë, shmangim sëmundjen dhe infektimin e njerëzve të tjerë. Policia është përgjegjëse për monitorimin e respektimit të këtyre masave.

## Masat themelore

---

- Nëse jeni i sëmurë, qëndroni në shtëpi.
- Lani duart rregullisht me ujë dhe sapun.
- Mbani një distancë prej të paktën 1.5 m nga njerëzit e tjerë.
- Është e mundur që të keni kontakt me një maksimum prej 10 personash në javë dhe kjo mundësisht në ambjent përjashta.
- Ndodheni në një vend publik (stacion treni, treg, dyqan, ...) ku është e pamundur të mbash distancën prej të paktën 1.5 m? Atëherë, rekomandohet mbajtja e maskës.
- Mbani gjithmonë një maskë me vete.

## Udhëtimi në një qytet tjetër ose jashtë vendit

---

- Është e mundur të shkoni në ekskursion, në fshat ose në qytet në Belgjikë për një ose më shumë ditë.
- Përdorni transportin publik (autobus, tramvaj apo tren)? Jeni mbi 12 vjeç? Mbani maskën ose një shall që mbulon gojën dhe hundën.  
Mund të shkoni në Hollandë, Gjermani dhe Luksemburg për:
  - të vizituar familjen tuaj;
  - të bërë pazar.

### Nga 15 qershori

- Nga 15 qershori, është e mundur të shkoni me pushime jashtë vendit.
- Është e mundur të udhëtosh në një nga vendet e Bashkimit Evropian, përfshirë edhe Mbretërinë e Bashkuar si dhe në Zvicër, Lishtenshtajn, Islandë dhe Norvegji.
- Lexoni me kujdes masat e marra jashtë vendit.

Ju mund t'i gjeni ato në faqen e internetit

[https://diplomatie.belgium.be/nl/Diensten/Op\\_reis\\_in\\_het\\_buitenland/reisadviezen](https://diplomatie.belgium.be/nl/Diensten/Op_reis_in_het_buitenland/reisadviezen)



Déontologie, neutralité, secret professionnel

## Puna

---

- Punoni në shtëpi sa më shumë që të jetë e mundur.
- Ju duhet të shkoni në vendin tuaj të punës? Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë distancën sociale prej të paktën 1.5 m. Kjo nuk është e zbatueshme? Atëherë, i kërkoni punëdhënësit tuaj një maskë.
- Keni ndonjë pyetje? Punëdhënësi do t'ju informojë lidhur me këtë çështje.

## Dyqanet

---

- Të gjitha dyqanet janë të hapura.
- Dyqanet e natës janë të hapura deri në orën 1 të mëngjesit.
- Tregjet e hapura lejohen.
- Mund të shkoni te parukieri ose në një sallon bukurie.
- Merrni takim paraprakisht.
- Pajisuni me maskë.

## Horeka

---

- Kafenetë dhe restorantet janë të hapura deri në orën 1 të mëngjesit.
- Rekomandohet të prenotoni paraprakisht.
- Maksimumi 10 persona për grup.
- Qëndroni ulur rreth tryezës suaj.

## Kontaktet shoqërore

---

- Është e mundur që të keni kontakte më të ngushta me 10 persona të ndryshëm në javë.
- Rekomandohet të takoheni në mjedis të jashtëm.
- Nuk mund të takoheni dot jashtë? Atëherë, ajrosni mirë ambientet: hapni dritaren.
- Dëshironi të bëni një aktivitet në grup (për shembull të shkoni në restorant, të shkoni në ekskursion ose të organizoni një vizitë në shtëpinë tuaj? Këto aktivitete janë të kufizuara në maksimum prej 10 personash).

## Ushtrimet

---

- Aktivitetet sportive me persona të tjerë lejohen.
- Është e mundur të bëni sport në një grup maksimal prej 20 personash.
- Mbani distancën prej të paktën 1.5 m edhe gjatë veprimtarisë sportive.



### Déontologie, neutralité, secret professionnel

- Nuk ka prani të publikut.
- Eshtë e mundur të bëni një aktivitet sportiv në palestër ose në klub sportiv.
- Kabina e veshjeve dhe dushet janë të mbyllura.
- Pishinat, saunat dhe qendrat lidhur me mirëqënien janë gjithashtu të mbyllura.

## Nga 1 korriku

---

- Nga 1 korriku, është e mundur të ushtroni sport me një maksimum 50 njerëz të pranishëm.
- Lejohet publiku.
- Publiku është i kufizuar në 200 persona maksimum. Duhet të qëndroni ulur.
- Mbani distancën prej të paktën 1.5 m.

## Kulturë

---

### Bibliotekat janë të hapura.

#### Nga 1 korriku

- Eshtë e mundur të shkosh në teatër, kinema apo koncert.
- Maksimumi deri në 200 persona, të gjithë të ulur.
- Mbani të paktën 1.5 m distancë.
- Rekomandohet të blini biletën tuaj paraprakisht me telefon ose në internet.
- Eshtë e mundur të vizitoni një park argëtimi ose park lojrash të mbuluar.
- Lejohen stazhet dhe kampet verore për fëmijë.

#### Nga 1 gushti

- Lejohen festat e pagëzimit dhe mbrëmjet e tjera festive.

#### Cfarë nuk lejohet akoma?

- Diskotekat ose klubet e natës nuk mund të rihapen ende.
- Evenimentet e mëdha (si për shembull, festivalet) nuk lejohen.

## Feja

---

- Kultet fetare mund të rifillojnë.
- Maksimumi deri në 100 persona të pranishëm. Nga 1 korriku, ky numër i njerëzve do të shtrihet deri në 200.
- Cdo lloj kontakti fizik është i ndaluar.



Déontologie, neutralité, secret professionnel

## Cerdhet dhe shkollat

---

- Cerdhet janë të hapura.
- Nxënësit e arsimit fillor, të mesëm dhe atij parashkollor rikthehen në shkollë.
- Shkolla ju informon për rikthimin në shkollë.

## Inkurajim

---

Këto masa janë të rëndësishme për shëndetin publik.

Të gjithë duhet t'i respektojnë ato. Faleminderit për kontributin tuaj. Të luftojmë të gjithë së bashku kundër koronavirusit.